



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 27 prill 2021, në mbledhjen e XXXVI-të (tridhjetë e gjashtë) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, Patriot Rudari dhe Florent Hasani. Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Administratës-DA, Fevzi Jetullahu, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DSHPMSH, Pajtim Balaj, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE dhe Elhame Kutllavci, Drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera shtoi, besoj që thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, kështu që mund fillojmë me punë, andaj urdhëroni nëse dikush dëshiron fjalën nëse jo unë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, është diçka që po e propozoj jashtë rendit të rregullt të rendit të ditës, fjala është për Propozim Vendimin për transferimin e mjeteve nga kategoria rezervë-kategoria e shpenzimeve kapitale. Vetëm desha t'ju informojë lidhur me arsyen pse nuk ka ardhur në procedura të rregullta kjo pikë, arsyeja është se Ministria e Financave dhe Transfereve të premtën më 23.04.2021 na ka kthyer përgjigje dhe rrjedhimisht nuk kemi pasur hapësirë me i dërgua më herët.

Projektet në shumë 380.930.00€ të cilët janë në kategorinë rezervë kisha dashur t'i sqaroj se pse këto mjete janë në këtë kategori, kemi 4 projekte kapitale të cilët janë votuar nga kjo assemble në buxhetin e viti 2021 por që Ministria për arsye të ndryshme i ka vendosur në kategorinë rezervë, njeri projekt është për rregullimin e hyrjeve banesore në vlerë 80.000.00€, pastaj kemi projektin për ndërtimin e shtëpive për raste sociale me vlerë 100.000.00€, kemi projektin për drunjtë dekorative me vlerë 100.000.00€, si dhe projektin për ndërtimin e QKMF-III në Podujevë në vlerë 100.930.00€, e që në total shuma është 380.930.00€. Arsyeja pse këto mjete kanë dalë në kategorinë rezervë është ajo që besoi që disa prej jush mundeni me qenë të informuar, fjala është për programin për investime publike e që është sistem i cili plotësohet në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, për arsye teknike zyrtarja që i ka plotësuar, Ministria e Financave i ka vendos në kategorinë rezervë për 3 projekte, pra për projektin, ndërtimi i shtëpive për raste sociale, mjetet janë pozicionuar në kategorinë rezervë për arsye se nuk është sqaruar që këto shtëpi janë pronë e Komunës dhe vetëm jepen në shfrytëzim dhe rrjedhimisht Ministria ka menduar që këto shtëpi do të jepen falas, ndërsa në rastet ku shtëpitë ndahen falas i bie që janë

subvencion e që faktikisht janë kapital për ne. Pastaj është projekti për ndërtimin e QKMF-III në Podujevë mjetet për të cilin për arsye të mungesës së arsyeshmërisë së projektit anë kaluar në kategorinë rezervë, mandej kemi edhe projektin për drunjtë dekorative për të cilin arsyeja pse mjetet janë vendosur në kategorinë rezervë janë sepse është konsideruar si investim kapital apo thënë ndryshe mall, do të thotë se të gjitha projektet të cilat janë votuar në buxhetin e vitit 2021, përjashtimisht drunjtë dekorativ të cilët tani veç janë në procedurë të prokurimit projekt ky i cili nuk është anashkaluar por vetëm që është paguar nga mallra dhe shërbime dhe në vend të kësaj, në shumën prej 100.000.00€ është inkuadruar projekti për ndërtimin e çerdhës në qytet-afër shkollës “Fan Noli” besoi që jeni në dijeni për cilin objekt bëhet fjalë, pra as projekti për drunjtë dekorative nuk është i anuluar, po e quaj kështu kushtimisht sepse vetëm paguhen nga mallrat dhe shërbimet, prandaj ftoj ta kaloni këtë propozim vendim. Sa më kujtohet këtë çështje e kam sqaruar pak a shumë edhe në mbledhjen e kaluar kur më është bërë pyetja rreth bartjes së mjeteve buxhetore, pra thjesht kanë qenë çështjet kohore që lidhen me Ministrinë e Financave dhe janë çështje kryesisht teknike që këto mjete buxhetore kanë kaluar në kategorinë rezervë, e që tani e kemi obligim sërish që për të njëjtat të merret vendim në Kuvendin e Komunës, çështje për të cilën jam në dijeni se shumë prej këshilltarëve të Kuvendit kanë përvojë dhe sigurisht janë në dijeni se këtu faktikisht është hera e parë që për shkak të disa Udhëzimeve Administrative të cilat është duke i aplikuar Ministria e Financave që projektet e miratuara nga Kuvendi i Komunës t’i vendosë në kategorinë rezervë.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, dëshiroj të paraqes qëndrimin e LDK-së, ne në përgjegjësi kemi qenë kundër kësaj forme të sjelljes me vonesë të pikave për rend të ditës, mirëpo se këto çështje para së gjithash kanë një rëndësi të madhe për projektet që janë në të mirë të qytetarëve, natyrisht që ne nuk jemi që t’i bllokojmë por miqësisht do t’i thosha drejtorit të DBF që kur ka pika të tilla dhe i konsulton miqësisht Grupet tjera do të ishte mirë të na konsultojë edhe neve ashtu siç bëri me Grupet tjera paraprakisht para fillimit të kësaj mbledhje, përndryshe ne mbetemi me idenë apo të paktën kemi shpresuar që në ndryshimin e pushtetit ashtu siç keni proklamuar ndoshta do të ndryshonte edhe orari i sjelljeve të këtyre pikave/temave, siç ishte kjo me vonesë.

z.Florent Hasani, theksoi, ne si Grup i LVV-së duke e ditur rëndësinë e këtyre pikave, e mbështesim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e mbështesim dhe njëkohësisht i rekomandojmë Kuvendit për përfshirje në rend të ditës dhe shqyrtimin e të njëjtës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka dikush tjetër të shtoj diçka rreth këtij propozimi të drejtorit të DBF, unë e hedh në votim që kjo pikë të hyjë si pikë e rendit të ditës në këtë mbledhje fillimisht, pastaj janë proceduar tjera.

Pas votimi Kryesuesi i Komitetit konstaton se me 5 vota për, asnjë votë kundër dhe 4 vota të përmbajtura përkrah për përfshirje në kuadër të rendit të ditës edhe pika shtesë, dhe atë;

- **Propozim vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë - 38 në kategorinë e shpenzimeve investime kapitale (burimi i financimit 10)**

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, tani e hedh në votim rendin e propozuar të ditës, përfshirë edhe pikën shtesë të miratuar paraprakisht.

Njëzëri miratohet rendi i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, duke përfshirë edhe pikën shtesë të përkrahur dhe miratuar paraprakisht.

1. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2020 në vitin 2021 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, edhe për këtë çështje është diskutuar edhe në mbledhjen kaluar të Kuvendit të Komunës dhe i kam jap disa arsyeshmëri pse paksa është vonuar sjellja e kësaj pike, pra lidhet me çështjet që kanë të bëjnë me Ministrinë e Financave, besoj që e keni parë edhe nga materiali se mjetet nga të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës të cilat nuk janë shpenzuar në vitin 2020, janë 669.619.13€, dhe atë nga programi i Administratës Komunale 342.671.59€, në Shëndetësi 28.466.61€ dhe Arsim 298.480.93€, mjete të cilat barten nga viti i kaluar, kështu që specifikacioni përkatës për projektet përkatëse ju është përcjellë me kohë dhe nuk po dëshiroj t'ju marrë kohë që t'ju lexoj sepse e posedoni të gjithë mirëpo diçka që desha të ju informoj është se të gjitha këto projekte të cilat janë për bartje nga viti 2020 në 2021 janë të hyra vetanake dhe të gjitha obligime kontraktuale, bëhet fjalë për kontrata të cilat janë të nënshkruara dhe kanë qenë në procedurë të kryerjes së punimeve të cilat janë lidhur por që nuk kanë arritur të përfundohen dhe rrjedhimisht është dashur të barten në vitin 2021 në mënyrë që të bëhen pagesat. Sa për informim vlera e kontratave apo obligimeve kontraktuale është rreth 7.465,978€, mirëpo në buxhetin e viti 2021 faktikisht inkuadrohen 3.286.000€, diferencë e këtyre obligimeve kontraktuale të cilat nuk mundet me u imponua në buxhetin e vitit 2021 por duhet të mbulohen me të hyrat vetanake, me një fjalë, meqë janë obligime kontraktuale ne patjetër duhet t'i mbulojmë, mirëpo edhe këto në rast se kemi ndonjë mendim ndryshe rrjedhimisht edhe këtu Ministria e Financave nuk na i bartë askund tjetër pa i mbuluar këto projekte të cilat kanë filluar në bazë të kontratave, kështu që ndoshta ne mund të kemi ndonjë mendim për ndonjë projekt tjetër për të hyrë në këtë bartje të mjeteve por rrjedhimisht nuk kemi rrugë tjetër për projekte tjera pa i mbuluar me mjete financiare këto projekte që rrjedhin nga obligimet kontraktuale të vitit 2020. Prandaj edhe për këtë pikë lus që ta miratoni qoftë sot në KPF por edhe në mbledhjen e Kuvendit të Komunës sepse është një domosdoshmëri që ne duhet ta bëjmë edhe si Ekzekutiv por edhe si Kuvend i Komunës.

z.Mehmet Gashi, theksoi, edhe pse ne jemi opozitë sa i përket qeverisjes lokale në Komunën e Podujevës, kur kemi të bëjmë me çështje në interes të qytetarëve siç është kjo pikë që po diskutojmë ne e përkrahim propozimin për bartjen e të hyrave vetanake, por edhe për faktin se është obligim ligjor dhe për atë që drejtori i DBF-së tha që gjitha ato mjete shkojnë për projekte të cilat janë të pa përfunduara po që në rast se nuk i paguajmë atëherë dihen obligimet, kështu që ne si Grup i LDK-së e përkrahim këtë pikë që t'i rekomandojmë Kuvendit.

z.Florent Hasani, theksoi, Grupi i LVV-së e përkrahë dhe i rekomandon Kuvendit për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne si Grup i këshilltarëve nga PDK-së e rekomandojmë për shqyrtim në Kuvend këtë pikë të rendit të ditës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka dikush të shtoj diçka rreth kësaj pike, atëherë e hedh në votim që të rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2020 në vitin 2021 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2021

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, besoj që edhe për këtë pikë materiali është dërguar me kohë dhe keni pasë mundësi ta analizoni dhe shqyrtoni, përkatësisht i'u kemi përmbajtur procedurës së rregullt për çka kemi bërë përpjekje maksimale që të jemi transparent në paraqitjen e shpenzimeve të buxhetit për vitin 2021. Në fund të këtij raporti i kemi paraqitur në formë të përgjithshme të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet, është lista e të gjitha shpenzimeve të cilat janë kryer nga ana e Komunës së Podujevës nga 1 janari 2021 deri më 31 mars 2021, kjo është një tabelë e cila është marrë bilanci dhe çdo pagesë, besoj që mund ta shikoni në raport ku është operatori ekonomik përfitues, numri i faturës dhe vlera financiare e cila i është pagur përfituesit, kështu që nëse nuk keni diçka për të shtuar lidhur me këtë pikë urdhëroni, mirëpo pastaj ju propozoj që ta rekomandoni për mbledhjen e Kuvendit ku do ta paraqesim në mënyrë më të detajuar.

z.Mehmet Gashi, theksoi, unë e kam lexuar këtë raport, mirë është që është bërë raporti me kohë kështu që kjo është edhe një obligim ligjor që të raportohet para Kuvendit në mënyrë që edhe ne si anëtarë të Kuvendit të japim kontributin për realizimin e buxhetit dhe inkasimit të të hyrave buxhetore brenda këtij vitit, përkatësisht periudhës përkatëse kohore siç është planifikuar. Më ka rënë në sy tek disa kategori të caktuara tek shpenzimet pak a shumë që i kam nxjerrë, te kategoria paga dhe mëditje nuk e di përse është tejkualuar shpenzimi sepse nëse e marrim dhe analizojmë për këtë periudhë duhet të jetë 25% e buxhetit të shpenzuar, do të thotë për paga nuk ndryshojnë pagesat, kështu që është forma në bazë të të cilës bëhen shpenzimet për paga, kështu që është një tejkualim dikund për rreth 80.000.00€ më shumë se që ka buxhet për këtë kategori dhe nëse shkohet me këtë trend edhe për periudhën tjetër të vitit. Te kategoria e mallra dhe shërbime janë shpenzuar vetëm 8.8% e buxhetit të planifikuar e që është shumë e vogël e shpenzuar, ishte dashur të jetë rreth 25% e buxhetit komunal të shpenzuar apo rreth 14%, pra edhe kjo nuk është sipas dinamikës që kërkohet. Pastaj te kategoria e subvencioneve janë 12%, tek investimet kapitale vetëm 3.5% i kemi të shpenzuara për këtë periudhë apo 276.543.00€. jemi të vetëdijshëm që kjo periudhë më shumë ka të bëjë me tenderime dhe çdo herë ka qenë një shpenzim më i ulët edhe në vitet e kaluara, mirëpo ka pasur kontrata edhe 2 vjeçare që ndoshta kanë mundur të realizohen dhe rrjedhimisht përqindja e shpenzimit të jetë më e lartë, tek shpenzimet këtë periudhë është 16.2% që mendoj se edhe kjo është e ulët edhe paraqet rrezik që mos shpenzohet buxheti por të mbetet suficid, nëse veç nuk merren parasysh vërejtjet e dhëna.

Te të hyrat vetanake është një rritje e inkasimit edhe kjo është gjë e mirë edhe pse Komuna e Podujevës nga të hyrat vetanake thuhet është prej komunave më të vogla në krahasim me ato më të mëdha sa i përket inkasimit të të hyrave vetanake, mirëpo ne kemi qenë edhe në periudhën e kaluar kështu, por këtë vit e kemi një ngritje dhe është shumë mirë kjo, por më ka rënë në sy tek lejet e ndërtimit i kemi vetëm 50€ inkasim, nuk e di sa janë paraparë, 3% e kemi shfrytëzimin, edhe pse nuk jam në dijeni sa është paraparë për shfrytëzim, nuk e di pse, dhe shtroj pyetje se a ka kërkesa për leje ndërtimi, kjo është shumë brengosëse përse kaq e ulët, përndryshe kjo informatë është ardhur për tu votuar në Kuvend dhe të njëjtën ne ia rekomandojmë Kuvendit, mirëpo tek raporti i shpenzimeve është shumë i ulët, por është mirë që në periudhën e ardhshme të ngritet, dhe atë që e thash edhe njëherë sa e vërejtja te kategoria e pagave, nëse shkohet me këtë trend nuk e di a do të na dalin për paga apo do të duhet të kërkojmë buxhet shtesë prej kategorive tjera, ndoshta e kam gabim, por drejtori mund të na sqaroj.

z.Florent Hasani, theksoi, ne Grupi i LVV-së e i rekomandojmë Kuvendit këtë pikë të rendit të ditës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-së i rekomandojmë Kuvendit për diskutim të këtij raporti.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim të raportit financiar për periudhën janar – mars 2021

3. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ju sqaroi se kjo pikë e rendit të ditës ka qenë edhe në seancën e kaluar dhe është sjell sërish për shqyrtim në këtë seancë, andaj ftoj drejtorin e DA të paraqet fjalën hyrëse rreth kësaj pike dhe arsyeshmërisë së ri sjelljes së kësaj pike në rend të ditës nga ana e Ekzekutivit të Komunës

z.Bahri Selimi, drejtor i DA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, si temë mendoj që është diskutuar goxha gjatë, krejt çka dua të shtoj është që kemi planifikuar edhe kohëzgjatjen e debatit publik, mandej kemi menduar dhe kemi propozuar edhe lokacionin ku do t'i mbajmë debatet publike por njëkohësisht edhe datat të cilat do të mbahen debatet publike, këtë po ua propozoj tani por me që po hapet diskutimi mendoj që jemi të hapur edhe për propozimet e juaja, mund ta ndryshojmë datën dhe lokacionin. Fillimisht ju them që kohëzgjatja e debatit publik është menduar të jetë 30 ditë dhe fillon nga data 03 maj 2021 deri me datën 03 qershor 2021. Kemi filluar nga data 3 për shkak edhe të disa festave që janë tani në fillim të muajit maj, ndërsa lokacionet në të cilat kemi menduar që të mbahen debatet publike janë siç e kemi diskutuar edhe paraprakisht, janë fshatrat Kerpimeh, Lluzhan, Orllan dhe qendra në Podujevë, kemi menduar që mjafton të mbahen 4 debate publike gjatë kësaj kohe duke i përfshirë qysh është edhe njëfarë tradite që i kemi përfshi në përgjithësi të gjitha kështu në këtë formë dhe datat të cilat kemi menduar të mbahen këto debate janë në fshatin Kerpimeh me datën 11.05.2021, në fshatin Lluzhan me datën 12.05.2021, në fshatin Orllan me datën 18.05.2021, dhe në zonën qytet me datën 19.05.2021. Nuk kam diçka tjetër sa i përket kësaj pike sepse arsyeshmëria është dhënë edhe në mbledhjen e kaluar kur edhe është shtyrë kjo pikë, por edhe në debatin e gjerë të zhvilluar lidhur me këtë temë, por që edhe që është bërë edhe më parë siç jeni në dijeni sepse një pikë e tillë është shtyrë dy herë deri më tani, mirëpo tani unë vetëm kërkoj nga ju që kjo pikë e rendit të ditës të merr edhe pëlqimin e juaj.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, domethënë që drejtori i DA-së e paska ditur që kanë me ndryshu masat me datën 18.04.2021, i kishte informatat e sakta por mirë i paskeni planifikuar datat dhe vendin ku keni me i mbajt takimet, por ne si Grup i LDK-së i mbetemi qëndrimit që e kemi jap më herët që ne duam një garancë prej jush që do t'i respektoni me përpikëri masat anti-covid kur dihet që ende nuk ka kaluar faza e rrezikshmërisë dhe ende nuk kemi lirim total të masave, duhet ta kemi parasysh që ka edhe vende tjera që kanë shtrëngim shumë më të madh të masave, përndryshe e kemi jap fjalën që e kemi rekomanduar por me garancën që do të respektohen masat anti-covid.

z.Florent Hasani, theksoi, Grupi i LVV-së i rekomandon Kuvendit për shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës, normal duke i respektuar masat anti-covid.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga PDK i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të kësaj pike.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, duke marr parasysh që Qeveria jonë tani vetëm ka filluar t'i liroj masat, atëherë unë mendoj që kjo pikë e rendit të ditës të procedohet në seancën e ardhshme të Kuvendit.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush ka edhe diçka të shtoj rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim, përfshirë edhe propozimet e drejtorit të Drejtorisë së administratës rreth kohëzgjatjes dhe vendeve për mbajtjen e konsultimeve publike.

z.Bahri Selimi, drejtor i DA, theksoi, me falni edhe njëherë ndoshta për shkak të procesverbalit sepse përmenda vetëm datat por jo edhe kohën dhe vendet e konsultimeve publike. Kemi menduar që në të gjitha lokacionet të mbahen debatet në objektet e shkollave sepse është hapësirë pak më e madhe ku mund t'i respektojmë edhe masat anti covid që është edhe kërkesë e të gjithëve këtu, ndërsa sa i përket

konsultimeve publike në qytet kemi menduar ta mbajmë në këtë sallë të Kuvendit, kurse për të gjitha këto takime publike kemi menduar që të mbahen nga ora 14:00 për të gjitha debatet publike përkatëse.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me konstatim që diskutimi publik të zgjatë 30 ditë, nga data 05 maj 2021 deri më 07 qershor 2021, ndërsa debatet publike me qytetar të mbahen në tri lokalitete, dhe atë:

- *Debati me banorët e fshatit Kërpimeh dhe fshatrave përreth, më 11 maj 2021, në shkollën e fshatit Kërpimeh në ora 14;00.*
- *Debati me banorët e fshatit Lluzhan dhe fshatrave përreth, më 12 maj 2021, në shkollën e fshatit Lluzhan në ora 14;00.*
- *Debati me banorët e fshatit Orllan dhe fshatrave përreth, më 18 maj 2021, në shkollën e fshatit Orllan, në ora 14;00.*
- *Debati me banorët e qytetit të Podujevës, më 19 maj 2021, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës (në ndërtesën e re të Komunës), në ora 14;00.*

4. Propozim Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa tarifa dhe gjoha Komunale

- Propozim vendimi për diskutim publik

z.Pajtim Balaj, drejtor i DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, siç e dini gjatë vitit të kaluar në një ndër seancat në fillim të pandemisë Kuvendi i Komunës ka vendosur që t'i liroj shumicën, më duket të gjitha bizneset, prej tarifës komunale. Në atë kohë edhe qëndrimi i Grupit të LVV-së me sa mbaj mend edhe shumica e këshilltarëve kanë mbajtur një qëndrim që duhet me u heq kjo taksë, prandaj ne e kemi menduar që është në të mirë të të bërit biznes, është një ndër lehtësira që mund t'ju bëhet këtyre bizneseve dhe lokaleve, andaj e kemi hartuar një draft të cilin e paraqesim para këtij Kuvendi, draft të cilin besoj që e keni marr me kohë dhe i cili është ashtu siç ne e kemi menduar por nuk është versioni final sepse shpresoj që do të konsultohemi me grupet e këshilltarëve të Kuvendit nga të gjitha subjektet politike, pasi që të merret pëlqimi për debat publik, në mënyrë që për versionin final të këtij dokumenti në fund të jetë njëfarë harmonizimi i qëndrimeve të të gjithëve, prandaj kërkoj nga ju që sot të merret aprovimi dhe t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, të vëhet në debat publik, pastaj për vërejtjet dhe sugjerimet ne jemi të hapur t'i korrigjojmë dhe harmonizojmë qëndrimet tona të përbashkëta.

Periudha e debatit publik që ne e kemi menduar është nga 03 maj 2021 deri më 03 qershor 2021, ndërsa periudha kur qytetarët, këshilltarët e Kuvendit dhe kushdo tjetër mund të dërgojnë propozime dhe sugjerime, kurse data 17 maj 2021 nga ora 10:00 mendojmë se është datë e përshtatshme për mbajtjen e debatit publik e cila propozohet të mbahet në këtë sallë të Kuvendit.

z.Mehmet Gashi, theksoi, edhe ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

z.Patriot Rudari, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e mbështesim këtë propozim që t'i rekomandohet Kuvendit, por mendoj që kjo ka mund të shkoj ndoshta edhe me një propozim vendim në mënyrë që të mos merr kohë kjo rregullore sa i përket debateve publike dhe proceduarve tjera. Pra ka mundur të sjellët me një propozim vendim të Kryetarit të Komunës për plotësim ndryshim të pikës përkatëse.

Si do që të jetë, ne i rekomandojmë Kuvendit që të vazhdohet me këtë pikë sipas materialit të dërguar, përndryshe meqë jështë dërguar edhe propozim vendimi për vënie në diskutim publik kjo pjesa e rregullores, unë mendoj që si procedurë ka mund të shkoj sikurse në rastin e parë në vitin 2020 kur edhe atëherë ishte pandemi që i liruam prej pronës publike me një vendim të Kuvendit i cili ishte shpall i plotfuqishëm për shkak të kohës.

Nuk dëshiroj të zgjasë më shumë por propozoj t'i rekomandohet Kuvendit dhe të vendos Kuvendi për këtë propozim për plotësim ndryshim të Rregullores në fjalë kështu siç është sjellë në Kuvend.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DPZHE, theksoi, ky propozim ka të bëjë me plotësim ndryshim të rregullores aktuale për taksa tarifa dhe gjoba komunale, kështu që i njëjti dokument duhet t'i nënshtrohet debatit publik dhe jam në dijeni se na merr kohë, por pak a shumë njerëzit janë aftësuar në këtë, kështu që kurrë nuk është vonë.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim këtë propozim Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale sipas materialit përkatës të dërguar dhe propozimeve të drejtorit të DPZHE sa i përket kohëzgjatjes, vendit dhe orarit të diskutimit publik.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me konstatim që diskutimi publik të zgjatë 30 ditë, nga data 05 maj 2021 deri më 07 qershor 2021, kurse debati publik me qytetar të mbahet më 17 maj 2021 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës (në ndërtesën e re të Komunës), në ora 10:00.

5. Propozim Rregullorja punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani”

- Propozim vendimi për diskutim publik

znj.Elhame Kutllovci, drejtoresh e DKRS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, Drejtorja e Kulturës Rinis dhe Sportit ka propozuar këtë rregullore për Këshillin Drejtues të Teatrit, dokument i cili është i bazuar në Ligjin për Teatrot dhe në Statusin e Teatrit “Avdush Hasani”.

Dëshiroj të theksoj se Teatrot e Kosovës fillimisht kanë probleme në realizimin e procedurave për kontraktimin e përfitueseve që kanë për të punuar në Teatrot e tyre, në këtë rast Këshilli Drejtues emërohet dhe shkarkohet me vendim të Kryetarit të Komunës, mirëpo përderisa emërohet dhe shkarkohet në këtë formë, Teatri “Avdush Hasani” respektivisht Këshilli Drejtues i Teatrit nuk ka të drejtë që t'i shfrytëzoj të gjitha kompetencat e tyre për realizimin e shfaqjeve për shkak se kodi buxhetor i Teatrit paraqet problem në raport me Ligjin për Financat dhe Ligjin për Teatro, prandaj me këtë rregullore ne e fuqizojmë Këshillin Drejtues në politikat e Teatrit.

Gjithashtu dëshiroj të potencoj se kjo rregullore është marr si model nga Komuna e Prishtinës, gjë që edhe ata e praktikojnë për Teatrin “Dodona”, kështu që ju kisha sugjeruar që ta kalojmë këtë në mënyrë që t'ia lehtësojmë punën e Teatrit “Avdush Hasani” në Podujevë. Sa i përket diskutimit publik, mendoj të zgjasë 30 ditë nga data 30 prill 2021 deri më 30 maj 2021, ndërsa debati publik me qytetarë dhe grupe të interesit propozoj të jetë data 10 maj 2021 duke filluar nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës së Podujevës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim, pastaj nëse ndokush ka diçka rreth kësaj propozim rregullore pastaj gjatë diskutimit publik apo edhe debatit publik mund të propozoj dhe sugjeroj.

z.Florent Hasani, theksoi, edhe ne Grup i këshilltarëve të LVV-së e mbështesim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim këtë propozim Rregullorë të punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani” sipas materialit përkatës të dërguar dhe propozimeve të drejtoreshës të DKRS sa i përket kohëzgjatjes, vendit dhe orarit të diskutimit publik.

z.Fatlume Jaha, theksoi, ajo që dëshiroj të them është që të rishikohen datat e propozimeve për diskutim dhe debate publike për këto dy pika të rendit të ditës sepse janë disa festa dhe mund të caktohen në ditë të festave diskutimi dhe debatet publike, siç është 3 dhe 4 maj 2021, pastaj 10 maj etj.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ne rregull nëse janë caktuar në ato ditë festash, atëherë të shtyhen ato data, përkatësisht nga 05.05.2021 deri me 07.06.2021, nëse veç pajtohemi të gjithë.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me konstatim që diskutimi publik të zgjatë 30 ditë, nga data 05 maj 2021 deri më 07 qershor 2021, kurse debati publik me qytetar të mbahet më 10 maj 2021 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës (në ndërtesën e re të Komunës), në ora 10:00

6. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare - për subvencionimin e bashkëfinancimit të ndërtimit të shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit në Komunën e Podujevës, me Shoqatën Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”

z.Rafet Llapashtica, theksoi, zakonisht i kemi mbështetur propozime të tilla sepse Komuna vazhdimisht i ka ndërtuar nga 10 shtëpi për raste sociale. Memorandum i Bashkëpunimit me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit”, sa e di unë është lidhur edhe në të kaluarën nga z.Nexhmi Rudari, por që edhe tani me Kryetarin aktual të Komunës z.Shpejtim Bulliqi. Ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e mbështesim këtë iniciativë sepse mendoj që të gjitha komunat e kanë një bashkëpunim me Shoqatën në fjalë, kështu që vetëm mbetet që Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale -DSHMS-së së bashku me ekipën mbështetëse të ndërtojnë shtëpitë për ata që kanë nevojë. Mendoj që shuma prej 50.000.00€ nuk është shumë e madhe që do të mund ta rëndonte buxhetin e Komunës andaj është mirë të përkrahim ky propozim vendim në mënyrë që si Komunë të jemi sadopak kontribuues në këtë projekt.

z.Mehmet Gashi, theksoi, edhe en Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

z.Florent Hasani, theksoi, gjithashtu edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-ës e përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e këtij propozim vendimi.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstaton se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare - për subvencionimin e bashkëfinancimit të ndërtimit të shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit në Komunën e Podujevës, me Shoqatën Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

7. Propozim vendimi për lirim nga taksa komunale – shfrytëzimi i hapësirave publike / tarracave pranë lokaleve të subjekteve afariste të gastronomisë dhe operatorët e transportit publik

z.Fevzi Jetullahu, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, DSHPMSH ka bërë këtë propozim duke e marr gjendjen dhe situatën për shkak të pandemisë tash e sa kohë në Komunën e Podujevës, kështu që ky propozim ka të bëjë kryesisht me shfrytëzimin e hapësirave publike që shfrytëzohen prej gastronomisë që është prej sektorëve më të prekur, ndërsa sa i përket fushës së transportit, bëhet fjalë jo vetëm për atë publik që është e cekur por edhe për atë privat, pra ta kemi parasysh sepse këtu kërkohet lirimi i transportuesve jo vetëm publik por edhe privat, përveç pjesës së radio taksive.

z.Rafet Llapashtica, pyetje për drejtorin parafolës, këta radio taksi, a janë privat apo publik.

z.Fevzi Jetullahu, drejtor i DSHPMSH, përgjigje parafolësit, theksoi, radio taksitë realisht janë privat, mirëpo tani në fillim të vitit e kemi futur një kompani të re ndërsa norma/taksa apo tarifa që është dashur që të paguhet për hapjen e këtij biznesi është paguar, kurse janë 3 tjera që operojnë dhe nëse tani i lirojmë këto 3 të tjerat mund të jetë njëfarë diskriminimi i pa kuptimtë, andaj kjo është arsye pse kemi vendosur kështu.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Komitetit, shtroj pyetje rreth punëtorëve të Stacionit të Autobusëve “Kosova Transit” se çka do të bëhet me ata dhe kërkoi sqarime për çështjet që ndërlidhen me ata punëtor.

z.Fevzi Jetullahu, drejtor i DSHPMSH, përgjigje Kryesuesit, theksoi, Stacioni i Autobusëve i Komunës së Podujevës tani e ka një Bord Menaxhues dhe çështjet që ndërlidhen me Stacionin nuk janë në kuadër të DSHPMSH-së por hyjnë në kompetencë të Komisionit të Aksionarëve, Bordit Menaxhues dhe Ministrisë së Infrastrukturës.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Komitetit, sqarim për pyetjen e shtruar, theksoi, kur e bëra pyetjen mendova se jam i qartë sa i përket lirimit apo jo nga taksat dhe tarifat për Stacionin e Autobusëve sepse edhe tema ishte për lirim nga taksat për operatorët e transportit publik.

z.Fevzi Jetullahu, drejtor i DSHPMSH, përgjigje Kryesuesit, theksoi, ne si DSHPMSH-se nuk kemi të bëjmë me Stacionin e Autobusëve në Podujevë, ajo është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës. Ne kemi hapësirat tona publike që i shfrytëzojnë kryesisht gastronomia, si dhe transporti që sipas një paralogarie ashtu siç unë e kam bërë, të gjitha ato të hyra për Komunën janë rreth 3.000.00€ në rast se do të paguhet taksa, kështu që më e arsyeshme më është dukur që t’i lirojmë në këtë vit, gjithnjë me shpresën se do të përmirësohet gjendja dhe situata e krijuar nga pandemia covid-19.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Komitetit, theksoi, mendoj se është mirë të shikohen çështjet që kanë të bëjnë me ata punëtorë qoftë në aspektin e punës qoftë në aspektin e pagave.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket çështjes së Stacionit të Autobusëve faktikisht me vendim ajo pronë është komunale sepse ka qenë edhe në menaxhim të AKP-së. Sa unë jam në dijeni bordi drejtues dhe punëtorët tjerë të Stacionit vetë financohet prej realizimeve të tyre. T’ju them të drejtën, unë si anëtar i komisionit të aksionarëve e kanë dërguar një shkresë në Kuvendin e Komunës sa i përket pronës e cila është në kompetencë të drejtorit të Drejtorisë përkatëse sepse kanë pasur disa mosmarrëveshje aty me operatorët ekonomik përkatës rreth pagesës nëse nuk gaboju si dhe drejtuesit e Stacionit kanë kërkuar nga Komuna që t’i jepet një shtytje financiare për paga të punëtorëve për një ose 2 muaj, nëse nuk gaboju, mirëpo në këtë seancë nuk është sjellë për shqyrtim dhe nuk jam në dijeni se ajo kërkesë a ka hasur në shqyrtim aty ku e kanë drejtuar, sido që të jetë mendoj që edhe bordi menaxhues është dashur që të vijë dhe të interesohen pak më shumë.

z.Mehmet Gashi, theksoi, sa i përket shfrytëzimit të hapësirave publike e di që ka qenë një tarifë për ata që kanë bërë kërkesa dhe iu ka lejuar mirëpo shumë biznese ka që nuk bëjnë kërkesa dhe e shfrytëzojnë hapësirën publike, dhe sa i përket kësaj unë kam një sugjerim që hapësirën duhet t'ia caktoj Komuna – Drejtoria përkatëse në mënyrë që të mos pengohet qarkullimi i lirë i qytetarëve. E them këtë sepse ka shumë të atillë që në trotuare vendosin karrige dhe i zënë teracat ku pastaj pengohen njerëzit të kalojnë nëpër rrugë, kështu që hapësirën duhet ta shfrytëzojnë vetëm atë pjesë ku nuk pengohet qarkullimi i qytetarëve, dhe në këtë aspekt e kam një vërejtje sepse qe sa kohë e kam vërejtur se në rrugën kryesore këtu në qytet, (para ish restorant “Benidona” në anën tjetër, afër bankës) aty është një hapësirë që edhe mbuloja është vendosur dhe nuk jam në dijeni a ka apo jo leje, por që janë vendosur karriget dhe qytetarët nuk kanë nga të lëvizin/ecin. Po ashtu është edhe tjetra hapësirë ku gjithëherë parkohen veturat para bankës dhe që pengohet shumë qarkullimi i qytetarëve që është në numër të madh por të gjitha ata duhet të kalojnë nëpër dhe pengojnë komunikacionin pastaj, prandaj është mirë që aty ku nuk ka pengesa nuk duhet të lejohen shfrytëzime të tilla që pengojnë qarkullimin e lirë të qytetarëve, pra kjo është një vërejtje që duhet ta ketë parasysh Inspeksioni apo organet kompetente sepse aty pengohet qarkullimi i lëvizjes së lirë të qytetarëve.

z.Fevzi Jetullahu, drejtor i DSHPMSH, theksoi, ne si DSHPMSH e kemi formuar komisionin për shqyrtimin e kërkesave për shfrytëzim të hapësirave dhe ata dalin në teren për secilin kërkesë veç e veç dhe identifikojnë çka kërkohet nga operatorët, kështu që ne brenda mundësive tona askujt nuk mund t'i japim më tepër se i takon mirëpo edhe t'i bllokojmë brenda nuk e kemi ndërmend sepse për shkak të pandemisë e kemi menduar që në aspektin horizontal me ju jap sa më shumë hapësirë që të mund të zhvillojnë gastronominë me theks.

z.Mehmet Gashi, theksoi, e kemi pasur rastin para bankës aty ku e cekta, andaj kush është kompetent për këtë, a e kenë vërejtur ndokush ku trotuari nuk është i lirë, ku edhe parkingje edhe karrige aty nuk mundet të lëvizë askush nëpër tretuar, unë nuk po them të mos i lironi nga pagesat por të kontrollohen aty ku pengohen qytetarët në lëvizje, prandaj ju lus për këtë sepse janë organet kompetente, Inspeksioni dhe policia që t'i largojnë dhe të lirojnë hapësirën publike për qarkullim të lirë të qytetarëve.

z.Fevzi Jetullahu, drejtor i DSHPMSH, theksoi, tek vendi që parafolësi e cekta, e kemi vërejtur edhe ne por aty vetëm se janë larguar, drejtoria e Inspeksionit e ka larguar atë tendën që ka qene aty dhe kjo normal që është kompetencë edhe e policisë edhe e Drejtorisë së Inspeksionit.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Komitetit, theksoi, Policia është ajo që duhet të bashkëpunoj në mënyrë që trotuaret të jenë të lira për qarkullim të qytetarëve dhe mos të pengohet në komunikacion sepse nuk është e drejtë, prandaj konsideroj se duhet të merren masat dhe ta kenë parasysh që të shfrytëzohen hapësirat që nuk pengojnë qarkullimin e lirë dhe që duhet të jepen në shfrytëzim.

z.Florent Hasani, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së mendojmë se kudo që jepet kjo e drejtë dhe që ka hapësirë të mbështetet kjo kategori, jo vetëm me lirim nga taksa në fjalë por të mbështeten edhe në forma tjera sepse është e nevojshme në këtë periudhë pandemike.

Pavarësisht kësaj ne e mbështesim këtë propozim vendim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së i rekomandojmë për shqyrtim Kuvendit të komunës këtë pikë të rendit të ditës.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka ndokush të shtoj diçka lidhur me këtë e hedh në votim këtë që të rekomandohet në kuvend.

U konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimit për lirim nga taksa komunale – shfrytëzimi i hapësirave publike / tarracave pranë lokaleve të subjekteve afariste të gastronomisë dhe operatorët e transportit publik, sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

8. Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc, i ngritur me Vendimin nr.prot.01-020/04-0026812/18 të datës 28 mars 2018

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Komitetit, theksoi, fillimisht dëshiroj të jap një sqarim rreth kësaj pike, fjala është për plotësim ndryshimin e vendimit ku anëtar ka qenë ish këshilltari i Kuvendit z.Vendenis Lahu i cili tani është Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, andaj edhe duhet të plotësohet përbërja e komisionit në fjalë me një anëtar tjetër të Kuvendit.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e propozojmë që në vend të ish anëtarit të Kuvendit z.Vendenis Lahu, në komisionin përkatës të jetë anëtar i Kuvendit z.Ragip Fetahu.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, e mbështesim këtë plotësim ndryshim, mirëpo besoj që nuk ka raste të ankesave sepse në të kundërtën ish anëtar i Kuvendit z.Vendenis Lahu duhet të zëvendësohet edhe në Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale në të cilin kemi qenë së bashku, sepse ai komision pastaj nuk mund të i shqyrtoj ankesat të cilat i ka si komision, por nëse paraqitet atëherë ndoshta duhet të bëhet plotësim ndryshimi përkatës.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me konstatim që në kuadër të Komisionit përkatës, në vend të ish anëtarit të Kuvendit z.Vendenis Lahu, propozohet z.Ragip Fetahu (anëtar i Kuvendit të Komunës)

9. Propozim vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë - 38 në kategorinë e shpenzimeve investime kapitale (burimi i financimit 10)

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se për këtë pikë të rendit të ditës e cila hyri si pikë shtesë u diskutua edhe në hyrje të kësaj mbledhje dhe u japën sqarimet e nevojshme, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit i cili u shpërnda në fillim të mbledhjes.

U konstatua se me 6 vota për, 3 vota të përmbajtura, dhe asnjë votë kundër, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim propozim vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë - 38 në kategorinë e shpenzimeve investime kapitale (burimi i financimit 10), sipas materialit përkatës të shpërndarë në fillim të kësaj mbledhje .

Kryesuesi i Komitetit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/01-0035166/21
Podujevë,
27 prill 2021**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**